

 Tel: +355 4 22 69097 +355 4 22 69325 Fax: E-Mail: info@dpa.gov.al	Udhëzime për zbatimin e dokumentave IAF MD 15 dhe IAF MD 12	Kodi DA-IN-009
		Rishikim nr 1 Dt 20.06.2017
		Faqe 1-4

Udhëzues për zbatimin e dokumentit IAF MD 15 dhe IAF MD 12

Zbatuesit: Stafi i DPA-së, vlerësuesit teknik dhe organizmat certifikues të sistemeve të menaxhimit

Përgjegjësi për zbatim: Drejtori i departamentit të akreditimit

Kontrolloi: Ardita MELE

Miratoi: Armond HALEBI



Tel: +355 4 22 69097

+355 4 22 69325

Fax:

E-Mail: info@dpa.gov.al

Udhëzime për zbatimin e dokumentave IAF MD 15 dhe IAF MD 12

Kodi DA-IN-009

**Rishikim nr 1
Dt 20.06.2017**

Faqe 2-4

1. QËLLIMI

Ky dokument përshkruan udhëzime për zbatimin e dokumenti IAF MD 15 dhe IAF MD 12. Ky dokument është i vlefshëm për DPA dhe vlerësuesit e saj si dhe për organizmat certifikues të sistemeve të menaxhimit që janë të akredituar nga DPA.

2. FUSHA E ZBATIMIT

Ky udhëzues zbatohet nga organizmat certifikues të sistemeve të menaxhimit të akredituar, vlerësuesit dhe stafi i DPA. Ky dokument i referohet standardin ISO/IEC 17021-1 por nuk bie në kundërshtim dhe nuk shfuqizon asnjë kërkesë të ISO/IEC 17021-1.

3. PËRGJEGJËSITË

Ky udhëzues është pjesë e sistemit të menaxhimit të cilësisë dhe si e tillë është nën përgjegjësinë e menaxherit të cilësisë të DPA rishikimi i vazhdueshëm në varësi të ndryshime të duhura dhe përmirësimeve të vazhdueshme në sistemin e cilësisë së DPA. Është detyrë e drejtorit të departamentit të akreditimit të kontrollojë zbatimin e këtij udhëzimi.

4. REFERENCA

SSH ISO/IEC 17011-1:2015,

S SH ISO/IEC 17011 :2005

IAF MD 5

IAF MD 2

IAF MD 15

IAF MD 12

5. FJALORI DHE SHKURTIME

Në këtë udhëzues është përdorur terminologjia e standardit ISO/IEC 17011:2004

IAF Forum Nderkombëtar i Akreditimit

DPA Drejtoria e Përgjithëshme e Akreditimit

6. PËRMBAJTJA

1. Të përgjithshme



Tel: +355 4 22 69097
+355 4 22 69325
Fax:
E-Mail: info@dpa.gov.al

Udhëzime për zbatimin e dokumentave IAF MD 15 dhe IAF MD 12

Kodi DA-IN-009

Rishikim nr 1
Dt 20.06.2017

Faqe 3-4

Në 14 Korrik 2012 është publikuar nga Forumi Ndërkombëtar i Akreditimit dokumenti IAF MD 15 “For the collection of data to provide indicators of management system certification bodies’ performance”. Zbatimi i këtij dokumenti ka filluar pas datës 14 Korrik 2016. Nga Forumi Ndërkombëtar i Akreditimit (IAF), kërkohet që të gjithë organizmat akreditues anëtar të IAF të përgatisin një udhëzues për mënyrën e mbledhjes së të dhënave nga organizmat certifikues të sistemeve të menaxhimit.

Mbledhja e të dhënave mbi performancën e organizmave certifikues të sistemeve të menaxhimit do të bëhet në bazë vjetore (brenda muajit Janar të cdo viti kalendarik).

Informacioni që do të jepet nga organizmat certifikues të sistemeve të menaxhimit do të përpunohet nga stafi i DPA dhe do të shërbejë për një planifikim më të mirë të vizitave mbikëqyrëse.

Në 7 Janar 2016 është publikuar nga Forumi Ndërkombëtar i Akreditimit dokumenti IAF MD 12 "Akreditimi i organeve të vlerësimit të konformitetit me aktivitetet në disa shtete . Zbatimi i këtij dokumenti ka filluar pas datës 7 Janar 2016. Ky dokument është i detyueshëm për zbatim për vlerësimin e organeve të vlerësimit të konformitetit që ofrojnë certifikime në shtete të tjera nga ato ku ndodhet zyra kryesore e trupës certifikuese.

2. Indikatorët e performancës

Për të realizuar një raportim sa më të saktë dhe të përdorshëm, kërkohet që raportimi të bazohet në indikatorët e mëposhtëm:

1. *Numri i certifikatave të akredituara të lëshuara deri në fund të Dhjetorit..* Numri i certifikatave të vlefshme do të raportohet si më poshtë:

- Nëse një klient mban një certifikatë të vlefshme e cila mbulon vetëm një vendndodhje, kjo do të numërohet si një certifikatë.
- Nëse një klient mban një certifikatë- e cila mbulon më shumë se një vendndodhje, kjo do të numërohet si një certifikatë, Nëse vendndodhjet e numërohen secila më vete.
- Kur një klient mban disa certifikata (për cdo vendndodhje) ose një certifikatë për disa vendndodhje, organizmi certifikues do të raportojë numrin total të certifikatave.
- Kur një klient është certifikuar kundrejt më shumë se një standardi të sistemit të menaxhimit dhe organizmi certifikues ka lëshuar vetëm një certifikatë që mbulon të gjitha standardet, atëherë organizmi certifikues do të raportojë aq certifikata sa sisteme menaxhimi janë certifikuar.



Tel: +355 4 22 69097
+355 4 22 69325
Fax:
E-Mail: info@dpa.gov.al

Udhëzime për zbatimin e dokumentave IAF MD 15 dhe IAF MD 12

Kodi DA-IN-009

Rishikim nr 1
Dt 20.06.2017

Faqe 4-4

Shënim: Certifikata të vlefshme nënkupton ato certifikime që kanë statusin aktiv ose të pezulluar. Certifikatat e tërhequra nuk duhet të numërohen dhe të raportohen.

2. **Numri i auditorëve të përdorur për cdo skemë certifikimi.**
3. **Numri i certifikatave (apo certifikimeve) të transferuara të pranuar nga organizmi certifikues.** Lutem referohuni dokumentit IAF MD 2.
4. **Numri i auditimeve të kryera me vonesë**
5. **Numri i ditëve të auditimeve të kryera (në kohë normale dhe me vonesë)** Lutem referohuni dokumentit IAF MD 5.

3. Mbledhja e të dhënave

Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit i kërkon të gjithë organizmave certifikues të sistemeve të menaxhimit të akredituar prej saj të japin informacion në brenda muajit Janar të cdo viti lidhje me:

- i) Shtetet në të cilat organizmi certifikues ka lëshuar certifikata të akredituara dhe, numrin e certifikatave të akredituara të lëshuara në secilin shtet;
- ii) Shtetet në të cilat organizmi certifikues ka degë ose zyrë që kryen aktivitete të certifikimit;
- iii) Shtetet në të cilat organizimi certifikues ka personel të vendosur atje që kryen cdo aktivitet certifikimi.
- iv) Cilat nga zyrat kryejnë ose menaxhojnë aktivitete kyce sic përcaktohet në IAF/ILAC A5 ose nga cilët persona të vendosur kryhen ose menaxhohen aktivitete kyce; dhe
- v) Masat e marra nga organizmat certifikues për menaxhimin e të gjitha aktiviteteve të kryera nga zyrat e vendosura në vendet e huaja ose nga personeli.

Informacioni i marrë do të përdoret nga DPA për hartimin e planit të vlerësimit në rastet e mbikëqyrjeve dhe riakreditimit si dhe planit të mbikëqyrjeve për gjithë ciklin e akreditimit.

Në rastin e zgjerimit të fushës së akreditimit, OVK duhet të japë informacionin e kërkuar në pikën 3 të këtij udhëzuesi që në fazën e aplikimit.

DPA zbaton politikën e saj DA-PO-002 dhe dokumentin IAF MD 12 për hartimin e programit të vlerësimit.